

ROLI I BASHKIMIT EVROPIAN NË PROMOVIMIN DHE NDËRTIMIN E
PAQES DHE STABILITETIT TË QËNDRUESHËM NË BALLKANIN
PERËNDIMOR - RASTET E STUDIMIT: BOSNJE-HERCEGOVINA,
KOSOVA DHE MAQEDONIA E VERIUT.

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I SHKENCËS NË INTEGRIME EVROPIANE DHE
ADMINISTRATË PUBLIKE

NGA

– SHPETIM [R] PRELVUKAJ –



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKE

PROGRAMI: INTEGRIME EVROPIANE DHE ADMINISTRATË PUBLIKE
PRISHTINË

– [SHKURT – 2022] –



~ EKSPOZE MBI TEZËN E NIVELIT MASTER ~

ROLI I BASHKIMIT EVROPIAN NË PROMOVIMIN DHE NDËRTIMIN E PAQES DHE STABILITETIT TË QËNDRUESHËM NË BALLKANIN PERËNDIMOR - RASTET E STUDIMIT: BOSNJE-HERCEGOVINA, KOSOVA DHE MAQEDONIA E VERIUT

Mentori:

Prof. Asoc. Dr. Bardhok Bashota

Studenti:

Shpetim Prelvukaj

Analizimi i studimeve vjen me një temë profesionale të ndërtuar me pasion dhe me dëshirën për të krijuar një hulumtim sa më serioz dhe cilësor, për një fushë të caktuar, që në të ardhmen ky studim të shërbej, si një pikë referimi edhe për gjeneratat e reja që vinë më pas. Pasi që fjala e fundit e ç’do studenti në një nivel të caktuar të studimeve është pikërisht përfundimi me sukses i temës së diplomës, që ne si student na profilizon në kuadër të asaj që kemi studiuar. Si rezultat i kësaj paraqes një temë mjaftë të ndjeshme dhe aktuale, ku dëshira për ta trajtuar këtë temë buron nga e kaluara e trishtë e këtyre vendeve dhe krijimi i një mundësie për gjetjen e një gjuhe të përbashkët në të ardhmen.

Vendet e Ballkanit Perëndimor, kanë trashëguar përgjatë historisë një mjedis të paqëndrueshëm dhe një të kaluar të trishtë, të shoqëruar me luftëra ndër-etnike, konflikte të armatosura, shkatërrime masive, vuajtje, kriza dhe mosmarrëveshje të ndërlikuara ndër-rajonale. Si rezultat i kësaj klime të krijuar ndër vite, dekada e shekuj më parë, faktorë të ndryshëm ndikuan në shpërthimin e luftërave dhe konflikteve të armatosura në zemër të Ballkanit, në fund të shekullit XX-të. Siç është shpërbërja përfundimtare e ish-Jugosllavisë, që tërhoqi vëmendjen ndërkombëtare dhe i tregoj botës peizazhin e gjakosur me luftërat në Bosnje-Hercegovinë, Kosovë dhe në fund edhe me konfliktet në Maqedoninë e Veriut. Ky shpërthim i ushqyer nga urrejtja dhe nacionalizmi ndërmjet etnive të ndryshme në rajon, të cilët ishin shkelur e shtypur dhe kishin vuajtur nga politika dhe sistemi i së kaluarës, ishte e mundur të shuhej vetëm me ndërhyrjen e fuqive të mëdha e cila ishte jetike dhe shpëtimtare për Ballkanin

Perëndimor. Përpjekjet njëpasnjëshme të Bashkimit Evropian (BE) dhe dorës së zgjatur të saj Politikës së Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët (PJSP), për të zgjidhur dhe ndërmjetësuar konfliktet e armatosura në rajon ndonëse dështuan, por shërbyen si një mësim për përpjekjet e reja, për ndërtimin dhe ruajtjen e paqes dhe stabilitetit pas luftës. BE-ja ka pasur dhe vazhdon të ketë një rol të pazëvendësueshëm në rajon nëpërmjet mbështetjes së vazhdueshme, për të krijuar një klimë pajtuese ndër-etnike, zhvillim ekonomik, sundim të ligjit, bashkëpunim rajonal, reforma të mbështetura në parimet dhe vlerat evropiane etj...

Pra që nga shpërbërja e ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (IRSFJ) dhe fillimit të krizave, luftërave dhe konflikteve të armatosura në Ballkanin Perëndimor, në të cilat u kryen mizori të paimagjinueshme, BE-ja është përpjekur gjithmonë të luajë një rol sa më aktiv, në zgjidhjen dhe ndërmjetësimin e këtyre konflikteve, nëpërmjet instrumenteve të saj, në veçanti nëpërmjet PJSP-së. Pavarësisht dështimeve për t'i zgjidhur këto konflikte, përpjekjet e vazhdueshme të BE-së i treguan botës, që ishte shumë skeptike, se kjo e fundit mund të jetë një aktor i rëndësishëm në arenën ndërkombëtare, për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes. Ndërkaq, dështimet për t'i dhënë fund konflikteve të armatosura dhe gjakderdhjeve të vazhdueshme, në Bosnje-Hercegovinë (1992-1996) dhe në Kosovë (1998-1999), ishin si rezultat i mungesës së një uniteti ndërmjet shteteve anëtarë, mungesës së instrumentit ushtarak, por edhe për faktin se politika e jashtme e BE-së ishte në fillimet e saj dhe ishte e papërgatitur për të trajtuar këto kriza. Si rezultat dështimi i BE-së për ti dhënë fund këtyre konflikteve në 'oborrin e sajë', do të mbetet një njollë e zezë e pashlyeshme në historinë e BE-së. Ato që luajtën një rol thelbësor dhe jetik për rajonin, duhet theksuar përfundimisht se ishin Kombet e Bashkuara, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO, të cilat me ndërhyrjen e tyre i dhanë fund luftërave në Ballkanin Perëndimor.

Si rezultat i dështimit në Ballkanin Perëndimor, konkretisht në fund të viteve të 90-ta, BE-ja u përball me sfida në shumë nivele, me dimension të brendshëm dhe të jashtëm, si parandalimi i konflikteve dhe luftërave në Ballkan, kërcënimet nga terrorizmi, kërcënimet hibride, migrimi dhe ndryshimet klimatike. Të cilat në një mënyrë ndikuan në reformat dhe forcimin e PJSP-së, si dhe zhvillimin e Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët (PSMP). Krahas kësaj BE-ja, zotëron tre politika kryesore për zgjidhjen e konflikteve dhe ndërtimin e paqes, të cilat janë PJSP-ja që është politika kryesore e BE-së, PSMP-ja dhe Politika

Evropiane e Fqinjësisë (PEF). Sot me zhvillimin e këtyre politikave, mund të themi se BE-ja është një aktor ndërkombëtar, pasi që pavarësisht disfatave dhe dështimeve, kontributi historik për paqen dhe sigurinë në Ballkanin Perëndimor është i pamohueshëm. Bazuar në shumë studime të ndryshme BE-ja, mund të konsiderohet një nga ofruesit më të rëndësishëm të operacioneve të paqes, në krahasim me organizata të tjera rajonale.

Pas përfundimit të luftërave dhe konflikteve të armatosura në rajonin e Ballkanit Perëndimor, filloj një fazë tjetër e cila kishte të bënte me ri-ngritjen/ndërtimin, stabilizimin dhe shtet-ndërtimin e këtyre vendeve të cilat lufta i kishte lënë të rrënuara. BE-ja, në këtë rast u angazhua me të gjithë mekanizmat e sajë, për ndërmjetësimin politik ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke vendosur kështu një ndihmë të konsiderueshme humanitare, mbështetje për të gjithë refugjatët dhe të zhvendosurit si rezultat i luftës së fundit, si dhe mbështetje masive financiare dhe asistencë teknike për ri-ndërtim të kapaciteteve dhe strukturave shtetërore. Krahas kësaj BE-ja, nëpërmjet operacioneve të saj për të mbështetur dhe ndërtuar paqen në këto vende, nxiti dhe shtyu vendet me qëllim krijimin e një demokratizimi dhe qëndrueshmërie të institucioneve, shoqërive dhe ekonomive në Ballkanin Perëndimor. Kjo u arrit nëpërmjet 'kushtëzimit' për përmbushjen e *'standardeve evropiane'* nga vendet e rajonit. Mund të themi, pa dyshim se BE-ja ka pasur një rol të pazëvendësueshëm, në zbatimin me sukses të të gjitha instrumenteve të saj, të fuqisë civile në formën e *'Paktit të Stabilitetit'* dhe *'Strategjisë së Zgjerimit'* për të përshpejtuar transformimin ekonomik dhe politik të vendeve Ballkanit Perëndimore.

Me fjalë të tjera mund të themi se paqja, siguria dhe stabiliteti kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë flamuri i politikës së jashtme të BE-së dhe shtyllat themelore të veprimit të jashtëm të saj. Pasi që BE-ja i ka dhënë një rëndësi dhe prioritet të madh, ndërtimit të paqes, në kuadër të politikës së saj të jashtme dhe të sigurisë. Që nga viti 2003 përfshirja e BE-së në ndërtimin e paqes pas konfliktit është bërë një nga elementët kryesorë në kuadër të misioneve dhe operacioneve të PSMP-së, që përqendrohet në avancimin e sundimit të ligjit, përmes një rendi ndërkombëtar të bazuar në rregulla, duke përfshirë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, parimet e barazisë dhe solidaritetit dhe respektimin e parimeve të Kartës së OKB-së.

Krahas misioneve dhe operacioneve paqe-ruajtëse dhe paqe-ndërtuese, është e rëndësishme integrimi dhe anëtarësimi i vendeve të rajonit në BE, kjo duke pasur parasysh faktin

se krijimi i një klime ku dominon qeverisja e mirë, respektimi i shtetit të së drejtës, mbrojtja e pakicave, qëndrueshmëria e shoqërisë dhe transformimi i kulturës politike janë elemente bazë të kriterëve të anëtarësimit në BE dhe vlerave evropiane. Ky proces mund të jetë i gjatë dhe i vështirë, për të gjitha vendet e rajonit të cilat mund të mos jenë në të njëjtin hap drejt rrugës së bashkimit, por është drita në fund të tunelit që sjellë paqen, stabilitetin, pajtimin, bashkëpunimin dhe prosperitetin në këto vende, të cilat më parë ishin të pa-imagjinueshme për vendet e një rajoni, që kanë kaluar mizoritë dhe tmerret e kohës. Prandaj është shumë e rëndësishme që të lihen mënjane armiqësitë dhe mosmarrëveshjet e trashëguara ndër vite dhe të shtrihet dora e pajtimit dhe bashkëpunimit, për të ecur dhe çarë përpara drejt të ardhmes evropiane.

~ PYETJET HULUMTUESE DHE HIPOTEZAT E STUDIMIT ~

Duke u bazuar në problematikën e shtruar më lart dhe për të realizuar sa më mirë punën time hulumtuese, ky punim diplome mbështetet në katër pyetje kërkimore dhe tri hipoteza të ngritura për hulumtim.

~ PYETJET KËRKIMORE TË HULUMTIMIT ~

- I. **Pyetje hulumtuese:** *Cili ishte roli i Politikës së Jashtme të Bashkimit Evropian në Ballkanin Perëndimor në kohën e luftërave Ballkanike dhe cili është roli i saj sot në kohë paqe?*
- II. **Pyetje hulumtuese:** *Sa arriti të ndikoj Bashkimi Evropian në zgjidhjen dhe menaxhimin e konflikteve në Ballkanin Perëndimor?*
- III. **Pyetje hulumtuese:** *Cilat janë sfidat e Bashkimit Evropian për ndërtimin e paqes dhe stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor?*
- IV. **Pyetje hulumtuese:** *Cilat janë hapat e ardhshëm të Bashkimit Evropian që luftërat dhe konfliktet e fund viteve të 90-ta, të mos përsëriten më?*

~ HIPOTEZAT E STUDIMIT ~

- I. **Hipoteza [1]:** *Kapacitetet e Bashkimit Evropian tejet të kufizuara dhe mungesa e një bashkimi dhe uniteti ndërmjet shteteve anëtare janë faktorët kyç që penguan BE-në, për të intervenuar në Ballkanin Perëndimor.*
- II. **Hipoteza [2]:** *Luftërat që shkatërruan rajonin e Ballkanit Perëndimor në fund të viteve 1990-të, përbënin një sfidë ekzistenciale për Politikën e jashtme të sigurisë të BE-së.*

III. **Hipoteza [3]:** *Ndërtimi i një paqe afatgjate në rajon ende është një rrugë e gjatë dhe pa shenja në horizont, pasi që marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërshtetërore në rajonin e Ballkanit Perëndimor vazhdojnë të mbeten të brishta.*

~ **METODOLOGJIA DHE METODAT E PËRDORURA NË PUNIMIN HULUMTUES** ~

Duke pasur parasysh që ç' do punim hulumtues, studimore apo shkencore u nënshtrohet disa kriterëve kornizë, si dhe metodave dhe formave hulumtuese e shkencore, nëpërmjet të cilave realizohet puna studiuëse në përgjithësi edhe kjo temë diplome, është një punim që kërkon një hulumtim dhe studim serioz e dinjitoz.

Metodologjia e punës, e cila do të përdoret në këtë punim i referohet metodave nga edhe janë mbledhur të dhënat, si dhe metodave që janë përdorur për strukturimin e të dhënave të mbledhura paraprakisht.

Metodat, mjetet dhe teknikat që janë përdorur për të realizuar këtë hulumtim, janë ato si në vijim:

- ↳ **Metoda e sasiore dhe cilësore** - përmes kombinimit të këtyre dy metodave, sigurojmë kuptimin dhe sqarimin e rasteve të ndryshme, ku behet një përmbledhje me e mire për objektin e hulumtimit.
- ↳ **Metoda e analizës së literaturës:** Nëpërmjet analizës së literaturës, do të mundohemi të japim rezultatet konkrete në lidhje më çështjen e parashtruar për studim.
- ↳ **Metoda e analizës historike:** Analiza këtu konsiston në ndryshimet që përjetojnë elementë të tillë si kompetencat, institucionet, procedura e vendimmarrjes, politikat etj., në Traktatet e Bashkimit Evropian.
- ↳ **Metoda e analizës krahasuese** - krahason dispozitat, procedurat, kuadrin ligjor, kuadrin institucional të përcaktuar në Traktatet e Bashkimit Evropian, duke filluar nga Traktati i Mahstrihtit dhe deri në Traktatin e Lisbonës për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët dhe ecurinë e saj.

~ QËLLIMI DHE RËNDËSIA E KËTIJ STUDIMI ~

Qëllimi i këtij punimi diplome është, që në mënyrën më të mirë të mundshme, të zhvillojë dhe të paraqesë një studim shkencorë dhe një analizë për rolin e Bashkimit Evropian dhe politikës së jashtme të saj, në ndërtimin e paqes dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor. Përveç rolit të politikës së jashtme të Bashkimit Evropian në Ballkanin Perëndimor, ky punim gjithashtu synon dhe ka për qëllim vlerësimin e ndërhyrjeve dhe misioneve paqeruajtëse të Bashkimit Evropian në Ballkan, me fokus të veçantë në rastin e Bosnjë Hercegovinës, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, duke i analizuar ato në përpikëmeri dhe në mënyrën më të mirë të mundshme. Rëndësia e këtij studimi qëndron në atë se është autentike dhe unike për tematikën e studimit, pasi që në gjuhën shqipe, por edhe në platformën ndërkombëtare është shumë e vështirë të hasësh në tema që merren vetëm me studimin e kësaj çështje. Me fjalë të tjera ky studim do ta informoj më shumë lexuesin për rolin e Bashkimit Evropian në Ballkanin Perëndimor dhe për përpjekjet e kësaj të fundit në menaxhimin e konflikteve dhe ndërmjetësimin e palëve që nëpërmjet kësaj të arrihet deri të ndërtimi i një paqe afatgjatë në mes të shteteve të cilat ishin historikisht në vatrën e luftërave dhe konflikteve të vazhdueshme.

~ STRUKTURA E PUNIMIT ~

Punimi është strukturuar në bazë të një analize konstruktive të ndarë në 6 pjesë kryesore. Secili nga kapitujt ka nën-ndarjet e veta dhe trajton aspekte të veçanta të hulumtimit të artikuluar në paragrafë dhe nen-paragrafë. Çdo kapitull trajtohet si një njësi e vetme, duke përmbledhur një numër të caktuar nën-kapitujsh, të cilat trajtojnë tema të veçanta në këtë fushe, por edhe në të njëjtën kohë të gjitha së bashku formojnë një element thelbësor, për ti dhënë punimit kuptimin më të mirë. Punimi fillon me kapitullin e parë, që përmban hyrjen e studimit, në këtë pjesë do të parashtrahet qëllimi, problemi dhe rëndësia e studimit, pyetjet kërkimore dhe hipoteza e studimit, struktura e punimit si dhe metodat, mjetet dhe teknikat që do të përdoren për të realizuar këtë hulumtim, duke ofruar një pasqyrë sa më të pastër të asaj që synohet të trajtohet apo shtjellohet në këtë studim. Me fjalë të tjera kapitulli i parë do të paraqes për lexuesin problematikën dhe çështjen kryesore të studimit. Ndërkaq, më pas ky studim do të ndahet në katër shtylla apo pjesë kryesore të cilat do të pasurohen edhe me nën kapituj, duke sjellë në mënyre kronologjike një studim të thellë për temën që është përzgjedhur për hulumtim.